

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.3068/Prot.

Tiranë, me dt.09/08/2022



U R D H Ë R  
VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

TIRANË

Për dijeni: Debitorit, Shoqëria "Albania Marketing Services" shpk

Adresa: Rruga "Abdyl Frashëri", Nr.31, Pallati Hekla, Kati 10

TIRANË

Për dijeni: Kreditorit, Tonin Preçi

Adresa; Rruga "Spiro Cipi", Pallati 7, Hyrja 3

TIRANË

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. çertifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.1637/Regj, bazuar në Titullin e Ekzekutimit Vendim Nr.2032 datë 14.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**KONSTATOVA:**

Se me datë; 27.07.2022 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Tonin Preçi, për vënien në ekzekutim të pikës 7 të dispozitivit të Titullit Ekzekutiv me palë dhe objekt:

**Kreditor : Tonin Preçi**

**Debitor : Shoqëria "Albania Marketing Services" shpk**

**Objekti : Pagim detyrimi**

Zyra përmbarimore, në mbështetje të nenit 133 të K. Pr. Civile, ka bërë shpalljen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar. Megjithëse palët debitore kanë marrë dijeni nuk kanë

vepruar për ekzekutimin e titullit në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 133 të K. Pr. Civile. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile, ekzekutimi i urdhërit të ekzekutimit ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 527, 529 të K. Pr. Civile, është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të palës debitore.

Sa sipër, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv duhet të kryhet bllokimi mbi kuotat/aksionet e palës debitore Shoqëria "Albania Marketing Services" shpk.

**Sa sipër, bazuar në nenin 527 e vijues të K. Pr. Civile;**

### **U R D H Ë R O J;**

Vendosjen e masës së sekuestros mbi kuotat/aksionet e palës debitore **Shoqëria "Albania Marketing Services" shpk me NIPT; K91425027V**, në mënyrë që të mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi.

Sekuestro duhet të vendoset në zbatim Titullit Ekzekutiv, Vendim Nr.2032 datë 14.04.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke respektuar rradhën e preferimit, bazuar në nenin 605 të K.Civil.


Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

*Lutemi, gjeni bashkalidhur kopje të Urdhërit të ekzekutimit*

### **PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**Ensola S. KUÇI**



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

Nr. 2543 Regj. Them  
Datë 03.08.2020

Nr.2032 Vendimi  
Datë 14.04.2022

V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

**GJYQTARE TEUTA HOXHA**

Me sekretare gjyqësore **Nadire Balla**, në seancën gjyqësore me dyer të hapura të datës 14.04.2022 mori në shqyrtim çështjen civile Nr. 2543 Akti që u përket:

**PADITËS:**

1. **Klajdi Hoxhallari**, i biri i Ajet-it, i dtl 26.05.1996, lindur në Pogradec, me kartë identiteti me nr. personal J60526076E, banues ne: Lagjja 5, Rr. 'Dhimiter Shkurti', banesa nr.3, Pogradec.
2. **Holger Deli**, i biri i Ilo-s, i dtl 13.04.1977, lindur në Korçë, me kartë identiteti me nr. personal H70413085D, banues në Korçë, në adresën: Lagjja 16, Rr. '28 nëntori', pallati 65, hyrja 1, ap.3, Korçë.
3. **Anisa Bala**, e bija e Sabaudin-it, e dt. 01.11.1988, me kartë identiteti me nr. personal I86101073R, lindur në Krujë dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rr. 'Islam Alla', pallati nr.5, shkalla 6, ap.11, Tiranë.
4. **Valbona Selamaj**, e bija e Bujar-it, e dt. 17.03.1989, me kartë identiteti me nr. personal I95317124M, lindur ne Sevaster (Vlorë) dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rr. 'Teki Selenica', (ish batalioni i sigurimit), shtëpi private, nr.404, Tiranë.
5. **Denisa Sollaku**, e bija e Gëzim-it, e dtl 01.05.1991, me kartë identiteti me nr. personal J15501002K, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rruga 'Filip Papajani', ndërtesa 20, Hyrja 1, Tiranë.
6. **Tonin Preçi**, i biri i Nikoll-ës, i dtl 20.08.1989, lindur në

Blinisht (Mirditë), me kartë identiteti me nr. personal I90820069C, banues në: Rr. 'Spiro Cipi', pallati 7, hyrja 3, Tiranë.

7. **Ana Livadhi**, e bija e Dedë-s, e dt. 15.10.1993, me kartë identiteti me nr. personal J36015084D, lindur në Shkodër, dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rr. 'Prenk Jakova', nr.5, Tiranë.

**I PADITUR:**

**Shoqëria tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k**, me NIPT K91425027V me adresë: Rruga "Abdyl Frasheri", Nr.31, pallati 'Hekla', kati 10, Tiranë, përfaqësuar me autorizimin datë 03.03.2021 nga Av.Mentor Bimi me Nr.3048 Licensa dhe NIPT L16919001Q.

**OBJEKTI:**

1. Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të dëmshpërblejë paditësin **Klajdi Hoxhallari** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 55,984 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të dëmshpërblejë Klajdi Hoxhallari me pagën neto të 1 muaji pagë, duke llogaritur në vlerën 55,984 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k për të dëmshpërblyer Klajdi Hoxhallari me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 55,984 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

2. Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të dëmshpërblejë **Holger Deli** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj.



Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë Holger Deli me pagën neto të 1 muaji page, duke llogaritur në vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k për të dëmshpërbleyer Holger Deli me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës së pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

3. Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë **Anisa Bala** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 54,724 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzetë e katër) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë Anisa Bala me pagën neto të 1 muaji page, duke llogaritur në vlerën 54,724 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzetë e katër) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k për të dëmshpërbleyer Anisa Bala me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 54,724 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzetë e katër) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës së pushimit kolektiv parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës. Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

4. Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë **Valbona Selamaj** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 45,498 (dyzetë e pesëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të dëmshpërblejë Valbona Selamaj me pagën neto të 2 muajve pagë, duke llogaritur në vlerën 45,498 (dyzetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k për të dëmshpërblyer Valbona Selamaj me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 45,498 (dyzetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës së pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të shpërblejë Valbona Selamaj me 2 muaj pagë duke e llogaritur në masën 45,498 (dyzetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) Lek/muaj, si shpërblim për vjetërsi në punë. Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

5. Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k të dëmshpërblejë **Denisa Sollaku** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" të dëmshpërblejë Denisa Sollaku me pagën neto të 1 muaji pagë, duke llogaritur në vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services" sh.p.k. për të dëmshpërblyer Denisa Sollaku me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës së pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

6. Detyrimin e shoqërisë tregtare "Albania Marketing Services"



sh.p.k të dëmshpërblejë **Tonin Preçi** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë Tonin Preçi me pagën neto të 2 muajve page, duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektimin e afatit të njoftimit zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k. për të dëmshpërbleyer Tonin Preçi me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj për mosrespektim të procedurës së pushimit kolektiv parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k. të shpërblejë Tonin Preçi me 3 muaj e gjysëm duke llogaritur masën 55,894 (pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër) Lek/muaj, shpërblim për vjetërsi në punë.

Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

7. Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k të dëmshpërblejë **Ana Livadhi** me pagën neto të 12 muajve për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, në bazë të pagës mujore në momentin ndërprerjes marrëdhënieve punës, duke llogaritur vlerën 46,352 (dyzetë e gjashtëmijë e treqind e pesëdhjetë e dy) Lek/muaj.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k. të dëmshpërblejë Ana Livadhi me pagën neto të 3 muajve page, duke llogaritur vlerën 46,352 (dyzetë e gjashtëmijë e treqind e pesëdhjetë e dy) Lek/muaj për mosrespektimin afatit njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e shoqërisë tregtare “Albania Marketing Services” sh.p.k për të dëmshpërbleyer Ana Livadhi me pagën neto të 6 muajve duke llogaritur vlerën 46,352 (dyzetë e gjashtëmijë e treqind e pesëdhjetë e dy) Lek/muaj për mosrespektim të procedureës së pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.

Ekzekutimin e përkohshëm të vendimit gjyqësor bazuar në nenin 317/b të Kodit të Procedurës Civile.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 31, 32,161 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 94/5,141,143, 145,148,153,155, të Kodit të Punës.

Gjykata,

- Si dëgjoi palën paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit të saj;
- Dëgjoi palën e paditur që gjatë gjykimit dhe në përfundim të tij kërkoi rrëzimin e padisë;
- Dhe si administroi provat e paraqitura prej palëve dhe shqyrtoi në tërësi çështjen;

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes**

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur padia me palë paditës dhe objektin e sipërcituar.

Në seancën përgatitore të datës 16.04.2021, Gjykata ka vendosur veçimin e gjykimit për paditësit Armando Ballanxhia, Luljeta Strefi, Malvina Toro dhe Serxhi Kulla dhe vazhdimin e gjykimit me pjesën tjetër të paditësve sipas pjesës hyrëse të vendimit për shkak të mosgjjetjes së lidhjeve të mjaftueshme të elementëve të gjykimit në një proces gjyqësor të vetëm të të gjithë paditësve në padinë fillestare.

Rezulton se paditësat Klajdi Hoxhallari, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Denisa Sollaku, Tonin Preçi dhe Ana Livadhi kanë qenë në marrëdhënie punë pranë palës së paditur shoqërisë “Albania Marketing Service” shpk., në pozicionin e punës të Operatorit telefonik.

Pala e paditur, shoqëria Albania Marketing Service (AMS) sh.p.k., ushtron aktivitetin tregtar në fushën e telemarketingut, e cila konsiston në ofrimin e shërbimit callcenter, nëpërmjet komunikimit chat, email, telefon etj.

Me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, si rrjedhojë e pandemisë “Covid- 19”, punëdhënësi shoqëria Albania Marketing Service sh.p.k., me urdhërimin e brendshëm nr. 0367, datë 30.03.2020 ka vendosur reduktimin e numrit të punonjësve.

Për këtë qëllim punëdhënësi ka bërë njoftimin individual të punëmarrësve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, bazuar në nenin 49 dhe 175/2 të Kushtetutës së Shqipërisë si dhe bazuar në neni 129/3 të Kodit të Punës. Në përmbajtjen e këtij njoftimi shprehimisht deklarohet se: “



- *Duke filluar nga data 06/04/2020, shoqëria AMS e ka të pamundur që t'ju zërë me punë gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe është e detyruar të ndërpresë marrëdhënien e punës.*
- *Palët nuk do të kenë ndonjë detyrim kundrejt njëra-tjetrës gjatë kohëzgjatjes së kësaj ndërprerje, cka do të deklarohet nga Punëdhënësi edhe pranë organeve përkatëse shtetërore.*
- *Kontrata e punës e lidhur mes nesh do të rifillojë efektet e saj, pas mbarimit të rrethanave që kanë shkaktuar ndërprerjen, kundrejt njoftimit të punëdhënësit.”*

Pavarësisht njoftimit se kontrata e punës e lidhur mes palëve do të rifillonte efektet e saj pas mbarimit të rrethanave që kishin shkaktuar ndërprerjen, pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, paditësat nuk janë marrë sërish në punë nga punëdhënësi, shoqëria Albania Marketing Service sh.p.k.

***Nga shqyrtimi gjyqësor rezulton se:***

**Paditësi Klajdi Hoxhallari** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 20.09.2018 në detyrën “Operator telefonik”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës të datës 20.09.2018. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1992, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k., librezës së punës si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”. Libreza e punës e punëmarrësit është mbyllur në datë 06.04.2020 me shënimin “*Papunësim për shkak të Covid-19*”.

Paditësi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 429 Prot., datë 06.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*”, nëpërmjet shërbimit postar në datën 10.04.2020, por nuk konfirmohet marrja dijani efektivisht nga ana e tij.

**Paditësi Holger Deli** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 30.05.2019 në detyrën “Operator telefonik”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës të datës 30.05.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1993, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k., librezës së punës si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”. Libreza e punës e punëmarrësit është mbyllur në datë 06.04.2020 me shënimin “*Papunësim për shkak të Covid-19*”.

Paditësi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 410 Prot., datë 06.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*”, konfirmuar nga nënshkrimi i tij në shkresën e njoftimit.

**Paditësja Anisa Bala** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 25.10.2019 në detyrën “Operatore telefonike”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës të datës 25.10.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 07.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1994, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k. si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”.

Paditësja është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 484 Prot., datë 07.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*”, por nuk konfirmohet marrja dijani efektivisht nga ana e saj.

**Paditësja Valbona Selamaj** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 15.02.2016 në detyrën “Operatore telefonike”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës datë 15.02.2016. Midis punëdhënësit dhe saj janë lidhur disa kontrata të tjera individuale, me afat të pacaktuar, konkretisht në datë 03.06.2016; datë 11.09.2017; datë 11.12.2017; datë 28.01.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1995, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k. si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”.

Paditësja është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 435 Prot., datë 06.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*”, nëpërmjet shërbimit postar në datën 10.04.2020, por nuk konfirmohet marrja dijani efektivisht nga ana e saj.

**Paditësja Denisa Sollaku** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 20.09.2018 në detyrën “Operatore telefonike”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës të datës 20.09.2018. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1996, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k., librezës së punës si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”. Librezja e punës e punëmarrëses është mbyllur në datë 06.04.2020 me shënimin “*Papunësim për shkak të Covid-19*”.

Paditësja është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 412 Prot., datë 06.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*”, nëpërmjet shërbimit postar në datën 09.04.2020, njoftim i kryer në adresën e deklaruar nga vetë paditësja nëpërmjet “deklaratës”, datë 24.09.2018. Rezulton se paditësja ka marrë dijani për këtë njoftim në datën 06.07.2020 (konfirmuar nga nënshkrimi i saj në shkresën e njoftimit).

**Paditësi Tonin Preçi** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 15.02.2016 në detyrën “Operator telefonik”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës të datës 15.02.2016. Midis tij dhe punëdhënësit janë lidhur edhe disa kontrata të tjera individuale me afat të pacaktuar, konkretisht me datë: 01.07.2016; datë

01.01.2017; datë 17.01.2019; datë 01.04.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1997, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k. si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”. Padiësi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 0427 Prot., datë 06.04.2020 nëpërmjet shërbimit postar në datën 07.04.2020, njoftim i kryer në adresën e deklaruar nga vetë padiësi nëpërmjet formularit “*Deklaratë*”, datë 12.10.2016, por nuk konfirmohet marrja dijëni efektivisht nga ana e tij.

**Padiësja Ana Livadhi** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 30.05.2019 në detyrën “Operatore telefonike”, me afat të pacaktuar, referuar kontratës individuale të punës datë 30.05.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020, referuar vërtetimit Nr. 1998, datë 15.10.2020 të lëshuar nga Albania Marketing Service sh.p.k. si dhe dokumentacionit të organeve tatimore “*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*”. Padiësja është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shkresën nr. 430 Prot., datë 06.04.2020 “*Njoftim për ndërprerjen e punës*” nëpërmjet shërbimit postar në datën 07.04.2020. njoftim i kryer në adresën e deklaruar nga vetë padiësja nëpërmjet “*deklaratës*”, datë 30.05.2019, por nuk konfirmohet marrja dijëni efektivisht nga ana e saj.

#### ***Pretendimet e palës padiëse***

- Punëdhënësi ka zgjidhur marrëdhënien e punës pa respektuar afatet e njoftimit, si rrjedhojë, referuar nenit 143/4 të Kodit të Punës zgjidhja trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm.
- Punonjësvë iu është njoftuar se do të riktheheshin në vendin e punës pas përfundimit të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore kundrejt njoftimit të bërë nga punëdhënësi, por kjo gjë nuk ka ndodhur. Referuar dokumentacionit tatimor, punëdhënësi i ka larguar nga puna të gjithë punonjësit në fillim të prillit 2020.
- Largimi nga puna si shkak i pandemisë nuk është i bazuar, sepse shoqëria ka mbajtur 2400 punonjës të tjerë në punë. Përveç kësaj, punëdhënësi, vetëm pas pak ditësh i ka zëvendësuar këta 64 punonjës me dhjetëra punonjës të tjerë. Në këto kushte, nuk ka qenë shkak gjendja e pandemisë për heqjen nga puna të këtyre punonjësve. Punëdhënësi mund të mos i zinte më punë gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, por t’i merrte më pas sërish në punë, ashtu siç edhe vet ka deklaruar në njoftimet e tij.
- Shkaku për të cilën punëdhënësi ka zgjidhur marrëdhënien e punës në mënyrë të menjëhershme nuk është nga ato të parashikuara nga neni 153/3 Kodit të Punës. Në këto

kushte zgjidhja e marrëdhënieve të punës është e menjëhershme dhe të pajustificuar, referuar nenit 155 të Kodit të Punës dhe punëmarrësve iu takon dëmshpërblim në masën 12 paga mujore.

- Referuar dokumentacionit tatimor, rezulton se numri i punonjësve është reduktuar nga 2602 punonjës në 2,537. Në këto kushte janë larguar 65 punonjës brenda 3 muajve, çka bën që punëdhënësi duhet të respektonte procedurën e parashikuar nga neni 148/1 i Kodit të Punës, për pushimet kolektive nga puna. Procedura e pushimit kolektiv përfshin njoftimin e organizatës sindikaliste përkatëse, zhvillimin e bisedimeve, njoftimin e Ministrisë së Punës, etj. Janë një sërë procedurash të cilat nuk janë zbatuar nga punëdhënësi në këtë rast, duke shkelur ligjin. Neni 148/6 parashikon se punëdhënësi, që nuk respekton procedurën pushimit kolektiv nga puna, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj pagë.
- Nga ana e punëdhënësit nuk janë respektuar afatet e njoftimit, të parashikuara nga neni 143 i Kodit të Punës. Data e përfundimit të marrëdhënieve të punës është e njëjtë për të gjithë 6 prill 2020. Afati i njoftimit për paditësit është i ndryshëm, konkretisht si më poshtë:
  1. Denisa Sollaku - datë fillimi pune 20.09.2018, afati i njoftimit duhet të ishte 1 muaj.
  2. Holger Deli- datë fillimi pune 30.05.2019, afati i njoftimit duhet të ishte 1 muaj.
  3. Anisa Bala - datë fillimi pune 25.10.2019, afati i njoftimit duhet të ishte 1 muaj.
  4. Valbona Selamaj - datë fillimi pune 28.01.2019, afati i njoftimit duhet të ishte 1muaj.
  5. Klajdi Hoxhallari - datë fillimi pune 20.09.2018, afati i njoftimit duhet të ishte 1muaj.
  6. Tonin Preçi - datë fillimi pune 01.02.2016, afati i njoftimit duhet të ishte 2 muaj.
  7. Ana Livadhi - datë fillimi pune 04.07.2013, afati i njoftimit duhet të ishte 3 muaj.
- Referuar nenit 148/6 të Kodit të Punës, paditësit mund të kërkojnë dëmshpërblimin që lidhet me pushimin kolektiv në kundërshtim me ligjin, por edhe pagën që do të kishin marrë në rast se do të zbatoheshin afati ligjor i njoftimit (*një mujor- dy mujor, sipas rastit*).
- Referuar nenit 145 të Kodit të Punës, dy nga paditësit kanë mbi 3 vjet në punë dhe rrjedhimisht plotësojnë kushtet ligjore për përfitimin e shpërblimit për vjetërsi në punë. Konkretisht:
  - Paditësja Malvina Toro, referuar kontratës së punës, ka filluar punë në 2012 dhe konform nenit 145/2 të Kodit të Punës përfiton 3 paga e gjysëm shpërblim për vjetërsi në punë.
  - Paditësi Tonin Preçi, referuar kontratës së punës, ka filluar punë në shkurt 2016 dhe konform nenit 145/2 të Kodit të Punës përfiton 2 paga shpërblim për vjetërsi në punë.

- Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të paditësve dhe të kushteve të vështira të ripunësimit të tyre, dhënie e vendimit në ekzekutim të përkohshëm.

***Prapësimet e palës së paditur:***

Shoqëria Albania Marketing Service (AMS) sh.p.k, ushtron aktiviteti tregtar në fushën e telemarketingut, e cila konsiston në ofrimin e shërbimit callcenter, nëpërmjet komunikimit chat, email, telefon etj.

Kushtet e pandemisë “Covid -19” dhe shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM nr. 243, datë 24.3.2020, ka sjellë si pasojë pakësimin e orëve të punës, si pasojë e rënies së kërkesave ndaj klientëve të Albania Marketing Service sh.p.k., përfshirë këtu dhe fushatën “Solde”, rrjedhimisht kjo ka diktuar pakësimin e numrit të punonjësve. Ky reduktim është bërë bazuar në urdhërimin e brendshëm nr. 0367, datë 30.03.2020. Punonjësit e mbajtur në punë janë ata me performancë më të mirë.

Pala e paditur ka prapësuar se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara dhe duhet të rrëzohen nga ana e Gjykatës, sepse:

- Largimet nga puna të punonjësve janë bërë në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas VKM nr. 243, datë 24.3.2020, si dhe bazuar në nenet 129/3 të Kodit të Punës, neneve 49 dhe 175/2 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku përcaktohet se, gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51 të Kushtetutës. Në këto kushte, pretendimet e palës paditëse për dëmshpërblimet përkatëse për mosrespektim të neneve 143, 144, 148 153 dhe 155 të K.Punës janë të pabazuara dhe duhet të rrëzohen nga ana e Gjykatës, pasi ato gjejnë zbatim në rastin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara si dhe pushimit kolektiv nga puna, por në kushtet normale.
- Në lidhje me shkakun e përfundimit të marrëdhënies së punës, vërtetohet nga aktet shkresore se zgjidhja e marrëdhënieve të punës është kryer në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, e cila ka shkaktuar shkurtimit të orëve të punës dhe uljen e kapaciteteve financiare, si dhe nevojës së klientëve të cilët operojnë në tregun Italian. Kjo e faktuar me kërkesën e klientit.
- Pretendimi se punëdhënësi duhej të respektonte procedurën e nenit 148/1 të K.Punës gjithashtu është i pabazuar, pasi pala paditëse ka paraqitur në cilësinë e provës të dhëna nga organet tatimore, për numrin e persona të larguar nga puna gjatë muajit prill 2020, të

cilët rezultojnë të jenë 65 punonjës, por nuk ka provuar se këta punonjës janë larguar për shkaqe që nuk lidhen me punëmarrësin.

- Kodi i Punës nuk parashikon konceptin e pezullimit të marrëdhënie të punës. Kontrata e punës është një kontratë e kushtëzuar me vullnetin e palëve, ne rastet që kontrata e punës është zgjidhur, ajo nuk mund të rifillojë efektet e saj në mënyrë automatike, pas mbarimit të gjendjes së jashtëzakonshme, por duhet të rilidhet përsëri, vetëm pasi palët në mënyrë të ndërsjellët ri-shprehin vullnetin për lidhjen e një kontrate të re pune. Kjo situatë nuk rezulton në rastin konkret.
- Në lidhje me njohjen e shpërblimit për vjetërsi, për paditësin Tonin Preçi, ky dëmshpërblim nuk mund të përfitohet në kushtet kur zgjidhja e kontratës së punës është kryer në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
- Paditësit rezultojnë të kenë përfituar ndihmën financiare 40,000 lekë të akorduar nga qeveria, sipas VKM Nr. 305, datë 16.4.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19”, pikës 2, për të ish punësuarit, të larguar nga puna deri në datën 10 prill 2020.
- Rrëzimin e kërimit për ekzekutimin e përkohshëm sipas nenit 317 të K.Pr.Civile, pasi paditësit nuk kanë paraqitur asnjë provë që të vërtetojnë kushtet veçanërisht të rënda të jetesës, si dhe faktit se të gjithë paditësit (përveç Tonin Preçi) janë në marrëdhënie pune.

Përfundimisht kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

## II. Ligji i zbatueshëm

### Kushtetutës së Shqipërisë

**Neni 49:** “1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.”

**Nenin 51:** “1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë memarrëdhëniet e punës, është e garantuar. 2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t’i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.”

**Neni 175:** "2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51. 3. Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni."

### **Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile**

**Neni 16§1:** "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët".

### **Dispozitat e Kodit të Punës**

**Neni 12:** "Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim".

**Neni 141:** "Kontrata e punës me afat të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit".

**Neni 143:** "1. Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej dy javësh, kur marrëdhënia e punësimit ka zgjatur deri në gjashtë muaj, prej një muaji, për kohëzgjatjen mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, prej dy muajsh, për kohëzgjatjen mbi dy vjet deri në pesë vjet, dhe prej tre muajsh, për kohëzgjatjen për më shumë se pesë vjet. 2. Shfuqizuar. 3. Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës zgjatet, sipas rastit, deri në fund të javës ose deri në fund të muajit. Zbatohet i njëjti rregull kur afati i njoftimit pezullohet gjatë periudhës së paafësisë për punë, shtatzënisë ose pushimeve të dhëna nga punëdhënësi. 4. Kur njëra nga palët e zgjidh kontratën pa respektuar afatin e njoftimit, zgjidhja trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm. 5. Gjatë periudhës së njoftimit, kur kontrata e punës zgjidhet nga ana e punëdhënësit, punëmarrësi përfiton, së paku, 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar punë të re. Kohëzgjatja e lejes dhe procedurat për marrjen dhe përdorimin e saj duhet të përcaktohen në kontratën kolektive ose individuale të punës".

**Neni 144:** "1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe

të bisedojë me të. 2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur. 3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes. 4. Shfuqizuar. 5. Punëdhënësi, i cili nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën e dy muajve, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme. 5/1. I takon punëdhënësit të provojë respektimin e procedurës së përcaktuar në këtë nen. 6. Kjo procedurë nuk zbatohet në rastet e pushimeve kolektive nga puna, por arsyet me shkrim për zgjidhjen e kontratës do t'i jepen punëmarrësit, sipas afateve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 148, të këtij Kodi".

**Neni 145:** "1) Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme.

2) Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15 ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e pagës të vitit paraardhës dhe indeksohet.

3) Shpërblimit për vjetërsi i shtohet shpërblimi që jepet në rastin e zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme ose të zgjidhjes me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të arsyeshme".

**Neni 148:** "1. Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës.

2. Kur punëdhënësi parashikon të bëjë pushime kolektive nga puna, ai duhet të njoftojë me shkrim organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve. Në mungesë të saj, punëdhënësi njofton punëmarrësit e tij nëpërmjet afishimit në mënyrë të dukshme, në vendin e punës. Njoftimi duhet të përmbajë veçanërisht arsyet e pushimit nga puna, numrin e punëmarrësve që do të pushohen, numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht, si dhe kohën gjatë së cilës është parashikuar të kryhen këto pushime.

Punëdhënësi i dorëzon ministrisë përgjegjëse për punën një kopje të këtij njoftimi.

3. Punëdhënësi bën këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në mungesë të saj, punëdhënësi u jep mundësi punëmarrësve të marrin pjesë në këshillime. Ato bëhen për marrjen e masave për të shmangur ose pakësuar pushimet kolektive nga puna dhe për të zbutur pasojat e tyre. Këshillimet



bëhen për një periudhë jo më pak se 30 ditë, duke filluar nga data e njoftimit, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përveç kur punëdhënësi pranon një kohëzgjatje më të madhe.

4. Punëdhënësi njofton, me shkrim, ministrinë përgjegjëse për punën për përfundimin e këshillimeve dhe i dërgon një kopje të këtij njoftimi palës së interesuar. Nëse palët nuk kanë rënë dakord, ministria përgjegjëse për punën i ndihmon ata të arrijnë një marrëveshje, brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit, të parashikuar në këtë pikë. Ministria përgjegjëse për punën nuk mund t'i ndalojë pushimet kolektive.

5. Punëdhënësi njofton punëmarrësit që do të pushohen nga puna, duke respektuar afatet e njoftimit, të përcaktuara në nenin 143, të këtij Kodi, pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, në rastin kur kemi një marrëveshje midis palëve dhe në rastin kur ndërhyjnë ministria përgjegjëse për punën, pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

6. Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna, të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj pagë dëmshpërblim, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143.

7. Punëdhënësi duhet t'u japë përparësi në rimarrjen në punë punëmarrësve të pushuar nga puna për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësit, nëse ai punëson punëmarrës me kualifikim të krahasueshëm".

**Neni 152:** "Në përfundim të marrëdhënieve të punës që kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsinë si në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të pacaktuar nga punëdhënësi".

**Neni 153:** "1) Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. 2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën vazhdimin e marrëdhënieve të punës. 3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si dhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit".

**Neni 155:** "1. Punëmarrësi ka të drejtën e pagës që do të kish fituar, nëse marrëdhëniet e punës do të kishin përfunduar në fund të afatit të njoftimit të parashikuar në ligj ose me kontratë ose në përfundim të kontratës me afat të caktuar. 2. Punëdhënësi mund të zbresë nga paga të ardhurat që punëmarrësi ka kursyer si rezultat i ndërprerjes së punës, të ardhurat nga një punë tjetër ose të ardhurat prej të cilave ai ka hequr dorë qëllimisht. 3. Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit

*pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim. 4. Nëse kontrata zgjidhet pa shkaqe të justifikuara, punëmarrësi ka të drejtë të ngrëjë padi kundër punëdhënësit, në gjykatën kompetente, brenda 180 ditëve nga dita e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Në rastin kur motivi i pajustificuar është zbuluar pas kalimit të këtij afati, punëmarrësi duhet të ngrëjë padinë brenda 30 ditëve nga dita e zbulimit të këtij motivi”.*

### **III. Analiza e Gjykatës**

#### *A. Lidhur me kërkimin për dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës*

Gjykata, pasi u njoh me pretendimet e palëve, pasi analizoi rrethanat e faktit dhe provat shkresore të paraqitura nga palët, arriti në konkluzionin se në rastin konkret jemi para një pushimi kolektiv nga puna, referuar nenit 148 të Kodit të Punës.

Konkretisht, nga aktet shkresore të paraqitura nga pala e paditur dhe të administruara si provë në këtë proces gjyqësor, u provua se largimet nga puna nuk janë kryer për shkaqe që lidhen me punëmarrësin. Shkaku i përfundimit të marrëdhënies së punës është kryer në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, e cila ka shkaktuar shkurtimin e orëve të punës dhe uljen e kapaciteteve financiare, si dhe nevojës së klientëve të cilët operojnë në tregun Italian. Konkretisht, nga ana e palës së paditur ky fakt u provua në këtë gjykim nëpërmjet komunikime elektronike me email me klientin italian “Scheduling Soldo”, të shoqëruara me vërtetim përkthimi nr.3179 Rep., datë 20.10.2020 si dhe me shkresën e datës 30.03.2020 me lëndë: “Shkurtimin e vendeve të punës, për odrimin e shërbimeve Soldo” drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njërëzore. Me anë të kësaj shkrese komunikohet shkurtimi i numrit të operatorëve telefonik nga 21 operatorë në 4 operatorë, diktuar kjo nga pamundësia ekonomike e klientit dhe mangësive në ofrimin e shërbimit.

Përsa më sipër, Gjykata konstaton se kërkitimi i palës paditëse për dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të rrëzohet.

Lidhur me prapësimin e palës së paditur shoqërisë Albania Marketing Service sh.p.k. se shkëputja e marrëdhënieve të punës me paditësat është bërë bazuar në neni 129/3 të Kodit të Punës, si rrjedhojë e pamundësisë së shoqërisë Albania Marketing Service sh.p.k. për të zënë me punë paditësat gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Gjykata konstaton se shkëputja e marrëdhënieve të punës me punonjësit është bërë mbi bazë të urdhërimit të brendshëm nr. 0367, datë 30.03.2020 për reduktimin e punonjësve. Në vijimësi punëdhënësi ka

bërë njoftimin individual të punëmarrësve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, bazuar në nenin 49 dhe 175/2 të Kushtetutës së Shqipërisë si dhe bazuar në neni 129/3 të Kodit të Punës.

Nëse i referohemi bazës ligjore të përdorur, pra nenit 129/3 të Kodit të Punës dhe përmbajtjes së këtij njoftimi, shprehet pamundësia e shoqërisë Albania Marketing Service sh.p.k. për të zënë me punë punëmarrësit (*paditësat në rastin konkret*) gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke u detyruar të ndërpresë marrëdhënien e punës me ta. Gjithashtu në këtë njoftim punëdhënësi deklaroi se kontrata e punës e lidhur mes tyre do të rifillonte efektet e saj, pas mbarimit të rrethanave që shkaktuan ndërprerjen, kundrejt njoftimit të punëdhënësit. Pavarësisht këtij fakti, pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, paditësat nuk janë marrë sërish në punë nga punëdhënësi, shoqëria Albania Marketing Service sh.p.k.

Gjykata konstaton se baza ligjore e përdorur nga punëdhënësi në rastin konkret, neni 129 i Kodit të Punës, parashikon refuzimin për të dhënë punë, konkretisht:

*"1. Nëse punëdhënësi refuzon të zërë me punë punëmarrësin, për një arsye që nuk lidhet me të, ai detyrohet të paguajë punëmarrësin edhe kur nuk vazhdon të punojë. 2. Punëdhënësi mund të zbresë nga paga atë që ka kursyer punëmarrësi për shkak të pengesës për të punuar ose që ka fituar duke kryer një punë tjetër ose fitim, nga i cili ka hequr dorë qëllimisht. 3. Bëjnë përjashtim rastet e forcave madhore, si dhe rasti kur punëmarrësi shkakton vetë me faj pamundësinë e kryerjes së punës."*

Kjo dispozitë parashikon një situatë të përkohshme ku punëdhënësi është në pamundësi për të zënë me punë punëmarrësin, për arsye që nuk lidhen me të, duke qenë njëkohësisht i detyruar që gjatë kësaj kohe edhe ta paguajë punëmarrësin. Ky është rregulli i përgjithshëm. Pra refuzimi për të zënë me punë, nuk çon në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, por punëmarrësi, pavarësisht se nuk punon për shkaqe sigurisht që nuk lidhen me të, do të paguhet. Kjo situatë është e përkohshme, derisa punëdhënësi të gjejë mundësinë për ta zënë me punë punëmarrësin.

Paragrafi i tretë i nenit 129 të Kodit të Punës parashikon dy raste përjashtimore kur, pavarësisht se janë kushtet e pamundësisë së punëdhënësit për t'i zënë me punë punëmarrësit, këta të fundit nuk do të përfitojnë pagën e tyre në: *rastet e forcave madhore* si dhe *rasti kur punëmarrësi shkakton vetë me faj pamundësinë e kryerjes së punës*.

Këto raste përjashtimore janë parashikuar për të mos rënduar pozitat e punëdhënësit, në rastin kur pamundësia e zëniës së punëmarrësve me punë ka ardhur nga forca madhore, të cilat dalin jashtë kontrollit të njëriut si dhe rastet kur kjo pamundësi ka ardhur si rezultat i veprimeve me faj të vet punëmarrësit, duke e çliruar punëdhënësin nga detyrimi i dhënies së pagës në këtë rast.

Pra në paragrafin e tretë të nenit 129 të Kodit të Punës kemi një situatë të punonjësve të pa zënë në punë dhe të papaguar. Por në asnjë rast, të pushuar nga puna. Kjo situatë e parashikuar në këtë

dispozitë është e përkohshme, derisa punëdhënësi të gjej një hapsirë tjetër për të mbuluar me punë punëmarrësin.

Në rastin objekt gjykimi, shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ka çuar në kufizimin e të drejtave të punëmarrësve për punë dhe për pagë, situatë e cila, sipas parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, do të vazhdonte e tillë deri në momentin e mbarimit të forcës madhore.

Gjykata konstaton se, në çështjen objekt gjykimi, punëdhënësi pavarësisht se ka përdorur si bazë ligjore nenin 129/3 të Kodit të Punës, *de facto* ka kryer ndërprerjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës me palët paditëse. Ky fakt u provua në gjykim me dokumentacionin nga organet tatimore "*Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020*", nga ku rezulton se marrëdhënia e punë për të gjithë paditësat ka përfunduar në datën 06.04.2020 (*me përjashtim të paditëses Anisa Bala të cilës i ka përfunduar në datë 07.04.2020*) si dhe referuar shkresës së printuar nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me ndihmën financiare, ku jepet lista e subjekteve përfitues. Në këtë listë rezulton se në datën 03.06.2020 paditësat Denisa Sollaku, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Klajdi Hoxhallari, Tonin Preçi dhe Ana Livadhi kanë statusin "*Miratuar*" për të përfituar ndihmën financiare të akorduar nga qeveria, sipas VKM Nr. 305, datë 16.4.2020 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19*", pikës 2, për të ish punësuarit, të larguar nga puna deri në datën 10 prill 2020. Për paditësat Klajdi Hoxhallari, Holger Deli dhe Denisa Sollaku ndërprerja e marrëdhënieve të punës konfirmohet edhe nga librezat e punës së paditësve, të depozituara në cilësinë e provës shkresore, ku figurojnë se marrëdhëniet e punës janë shkëputur në datë 06.04.2020 me shënimin "*Papunësim për shkak të Covid-19*".

Sa më sipër, Gjykata e gjen këtë prapësim të palës së paditur të pabazuar në ligj dhe në prova.

#### *B. Lidhur me kërkimin për mosrespektim të afatit të njoftimit*

Me qëllim mbrojtjen e interesave të punëmarrësve kundrejtë qëndrimeve arbitrare në largimet nga puna nga ana e punëdhënësit, Kodit të Punës në Kreun XIV të tij ka parashikuar rregullimet ligjore të përfundimit të marrëdhënieve të punës.

Referuar nenit 141 të Kodit të Punës, e drejta e zgjidhjes së kontratës së punës i takon si punëdhënësit ashtu dhe punëmarrësit, por ushtrimi i kësaj të drejte nga njëra palë duhet të bëhet duke respektuar afatin e njoftimit, me qëllim shmangien e cenimit të të drejtat dhe interesat e palës tjetër.

Ligjvënësi ka përcaktuar dy mënyra të zgjidhjes së kontratës së punës:

- A. *Zgjidhjen normale ose të rregullt, ç'ka nënkupton zgjidhjen e kontratës së punës duke respektuar afatin e njoftimit dhe procedurën e përcaktuar shprehimisht në ligj, dhe*
- B. *Zgjidhjen e jashtëzakonshme, në të cilën zgjidhja e kontratës është me efekt të menjëhershëm d.m.th. pa respektuar afatin e njoftimit.*

Duke iu referuar dispozitave të Kodit të Punës, kriteret ligjore për të klasifikuar zgjidhjen e kontratës së punës si të rregullt, janë:

- (i) *Procedura,*
- (ii) *Afati i njoftimit,*
- (iii) *Inkzistenca e motivit abuziv (kusht negativ).*

Gjykata konstaton se në lidhje me zgjidhjen e kontratës me afat të pacaktuar (*sikurse në rastin konkret*), Kodi i Punës në nenin 141 të tij, parashikon se: ***“Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra prej palëve dhe ka përfunduar afati i njoftimit”.***

Afati i njoftimit ka rëndësi të veçantë për faktin se ai i shërben palës tjetër, në rastin konkret palës punëmarrëse, për të marrë masa për të gjetur një punë të re, për të shmangur sa më shumë efektet sociale negative të papunësisë.

Neni 148/6 i Kodit të Punës parashikon se: ***“Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna, të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj pagë dëmshpërblim, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143.”***

Nëse referojmë në nenin 143 të Kodit të Punës, si dispozita që përcakton afatet e njoftimit pas kohës së marrjes në provë, citojmë se: ***“1) Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji. Gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune...”***

Nga provat e depozituara nga pala e paditur, të administruara në cilësinë e provës, rezulton se punonjësit e larguar nga puna janë njoftuar individualisht me shkresën me lëndë ***“Njoftim për ndërprerjen e punës”***, në datën 06.04.2020, datë kur edhe efektivisht i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Sa më sipër, Gjykata konkludon se punëdhënësi nuk ka respektuar afatin e njoftimit të parashikuar në neni 148/6 të Kodit të Punës, për rrjedhojë, ka vend për pagimin e dëmshpërblimit për shkak të mosrespektimit të këtij detyrimi ligjor.

Gjykata çmon se nuk ka rëndësi për çështjen konkrete marrja në analizë e faktit të marrjes dëjani efektivisht nga ana e punëmarrësve të këtij njoftimi, pasi në çdo rast ai konsiderohet jo i kryer nga ana e punëdhënësit, në kushtet kur në datën 06.04.2020 që mban shkresa për njoftim, është datë kur punonjësit *de facto* kanë qenë të pushuar nga puna.

Në këto kushte, referuar nenit 148/6 të Kodit të Punës, punëdhënësi shoqëria Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet t'i paguajë paditësve Klajdi Hoxhallari, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Denisa Sollaku, Tonin Preçi dhe Ana Livadhi dëmshpërblimin përkatës për mosrespektim të afati të njoftimit. Konkretisht, si më poshtë:

**Paditësi Klajdi Hoxhallari** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 20.09.2018. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, afati i njoftimit është një muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësit Klajdi Hoxhallari në masën e 1 (një) page mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësi Holger Deli** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 30.05.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, afati i njoftimit është një muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësin Holger Deli në masën e 1 (një) pagë mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësja Anisa Bala** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 25.10.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 07.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur deri në gjashtë muaj, afati i njoftimit është dy javë. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësen Anisa Bala në masën e ½ (gjysëm) page mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësja Valbona Selamaj** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 15.02.2016. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi dy deri në pesë vjet, afati i njoftimit është dy muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësen Valbona Selamaj në masën e 2 (dy) paga mujore, për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësja Denisa Sollaku** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 20.09.2018. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020.

Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, afati i njoftimit është një muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësen Denisa Sollaku në masën e 1 (një) pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësi Tonin Preçi** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 15.02.2016. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi dy deri në pesë vjet, afati i njoftimit është dy muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësin Tonin Preçi në masën e 2 (dy) paga mujore, për mosrespektim të afatit të njoftimit.

**Paditësja Ana Livadhi** ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. në datën 30.05.2019. Marrëdhëniet e punës kanë zgjatur deri në datën 06.04.2020. Referuar nenit 143/1 të Kodit të Punës, për marrëdhëniet e punës që kanë zgjatur mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, afati i njoftimit është një muaj. Sa më sipër, punëdhënësi Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet të dëmshpërblejë paditësen Ana Livadhi në masën e 1 (një) page mujore, për mosrespektim të afatit të njoftimit.

*C. Lidhur me kërkimin për mosrespektim të procedurës pushimit kolektiv të parashikuar nga neni 148/6 i Kodit të Punës.*

Gjykata çmon se në rastin konkret plotësohen kushtet e lindjes së detyrimit për punëdhënësin për të respektuar procedurat e pushimit kolektiv nga puna, në respektim të nenit 148 të Kodit të Punës.

Referuar shkresës nga organet tatimore "Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishitazi, si dhe e të larguarve nga puna nr.2183, datë 14.04.2020", rezulton se numri i të punësuarve nga puna për periudhën prill 2020 është 65 punonjës. Neni 148 i Kodit të Punës parashikon se: "1. Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës...". Në kushtet kur pala e paditur ka mbi 200 punonjës (përkatësisht 2602 punonjës) dhe numri i largimeve është mbi 20 punonjës (përkatësisht 65 punonjës), plotësohen kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë për t'u trajtuar pushimi i paditësve si pushim kolektiv nga puna. Rezulton se pala e paditur, e cila ka edhe barrën e provës në rastin konkret, nuk ka paraqitur prova shkresore në mbështetje të prapësimeve të saj se nuk është rasti i një pushimi kolektiv nga puna, për të provuar se largimi nga puna i një pjesë prej të larguarve në muajin prill 2020 (pra të disa prej 65 punonjësve), të ishte bërë për shkaqe që lidhen me vet punëmarrësin.

Sa më sipër, Gjykata çmon të drejtë pretendimin e palës paditëse se jemi para një pushimi kolektiv dhe gjen zbatim neni 148 i Kodit të Punës.

Gjithashtu, Gjykata çmon të pabazuar prapësimin e palës së paditur se nenet 144 dhe 148 të Kodit të Punës nuk gjejnë zbatim në rastin objekt gjykimi, në rrethanat kur largimet nga puna të punonjësve janë bërë në kushtet VKM nr.243, datë 24.3.2020, pasi kjo e fundit ka parashikuar se gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51 të Kushtetutës, pra edhe e drejta për punë. Por kjo nuk do të thotë që nga ana e punëdhënësit të shkelen procedurat për largimet nga puna. Me përfundimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore punëdhënësi është i detyruar të respektojë procedurat e parashikuara në Kodin e Punës, në rastet e zgjidhjeve të marrëdhënieve të punës.

Gjykata, sa më sipër, konstaton se nga pala e paditur nuk është respektuar procedura e parashikuar nga neni 148 i Kodit të Punës për rastin e pushimit kolektiv nga puna. Në këto kushte, referuar nenit 148/6 të Kodit të Punës, punëdhënësi shoqëria Albania Marketing Service sh.p.k. detyrohet t'i paguajë paditësve Klajdi Hoxhallari, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Denisa Sollaku, Tonin Preçi dhe Ana Livadhi një dëmshpërblim deri në 6 muaj pagë secilit.

#### *Ç. Lidhur me kërkimin për shpërblimin për vjetërsi në punë*

Pala paditëse ka pretenduar se referuar nenit 145 të Kodit të Punës, dy nga paditësit kanë mbi 3 vjet në punë dhe rrjedhimisht plotësojnë kushtet ligjore për përfitimin e shpërblimit për vjetërsi në punë. Konkretisht:

- Paditësja Malvina Toro, referuar kontratës së punës, ka filluar punë në 2012 dhe konform nenit 145/2 të Kodit të Punës përfiton 3 paga e gjysëm shpërblim për vjetërsi në punë;
- Paditësi Tonin Preçi, referuar kontratës së punës, ka filluar punë në shkurt 2016 dhe konform nenit 145/2 të Kodit të Punës përfiton 2 paga shpërblim për vjetërsi në punë.

Pala e paditur ka prapësuar se në lidhje me njohjen e shpërblimit për vjetërsi, për paditësin Tonin Preçi, ky dëmshpërblim nuk mund të përfitohet në kushtet kur zgjidhja e kontratës së punës është kryer në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Në lidhje me shpërblimin për vjetërsi në punë të paditëses Malvina Toro, Gjykata çmon se ky kërkim në diskutimin përfundimtar të palës paditëse është një lapsus, përse kohë që për këtë paditëse është bërë veçimi i padisë.



Në lidhje me paditësin Tonin Preçi, Gjykata çmon se prapësimi i palës së paditur është i pabazuar. Tashmë Gjykata e Lartë ka krijuar një qëndrim të konsoliduar se shpërblimi për vjetërsi në punë nuk është sanksion ndaj punëdhënësit, por është një formë vlerësimi material për punëmarrësin, për kontributin ky i fundit ka dhënë për punëdhënësin. Punëmarrësi e humbet këtë të drejtë vetëm në rastet përjashtuese të parashikuara në nenin 145 të Kodit të Punës, në rastin kur është pushuar nga puna me efekt të menjëhershëm për shkaqe të arsyeshme. Në çdo rast kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye që kanë të bëjnë me punëdhënësin dhe ekzistojnë kushtet e nenit 145 të Kodit të Punës, punëmarrësi përfiton shpërblimin për vjetërsi në punë. Përsa i përket masës të këtij shpërblimi, ai përcaktohet sipas kriterëve të pikës 2 të nenit 145 të Kodit të Punës.

Neni 145 i Kodit të Punës parashikon se: *“Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm, për shkaqe të arsyeshme”*.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se shpërblimi për vjetërsi përfitohet vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte:

- a) kontrata e punës është zgjidhur nga punëdhënësi;
- b) marrëdhënia e punës ka zgjatur jo më pak se tre vjet;
- c) zgjidhja e kontratës së punës nuk duhet të ketë ndodhur në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuar.

Gjykata çmon se në rastin konkret punëmarrësi Tonin Preçi plotëson kushtet e përfitimit të shpërblimit për vjetërsi në punë. Konkretisht:

Kushti i parë plotësohet, pasi më lart u provua se zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë nga punëdhënësi, në zbatim të urdhërimit të brendshëm nr. 0367, datë 30.03.2020 për reduktimin e numrit të punonjësve, si rezultat i shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, si rrjedhojë e pandemisë “Covid- 19”.

Po ashtu, plotësohet edhe kushti i dytë, pasi rezulton se paditësi Tonin Preçi ka filluar punë pranë palës së paditur Albania Marketing Service sh.p.k. nga data 15.02.2016 deri në datën 06.04.2020. Pra rezulton se marrëdhëniet e punës kanë zgjatur mbi 3 vjet.

Së fundi, plotësohet edhe kushti i tretë, pasi nga analiza e fakteve dhe provave të çështjes, Gjykata arriti në përfundimin se kontrata e punës nuk është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuar, por është zgjidhur për shkaqe që nuk lidhen me punëmarrësin.

Në këto kushte, gjykata vlerëson se paditësi Tonin Preçi përfiton shpërblim për vjetërsi në punë.

Duke qënë se marrëdhënia e tij e punës ka zgjatur 4 vite, punëdhënësi detyrohet t'i paguajë paditësit Tonin Preçi shpërblimin për vjetërsi në masën e 2 (dy) muajve pagë.

*D. Në lidhje me kërkimin për dhënie e vendimit në ekzekutim të përkohshëm*

Pala paditëse ka kërkuar dhënie e vendimit në ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të K.Pr.Civile, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike të paditësve. Pala e paditur ka kërkuar rrëzimin e këtij kërkitimi, pasi paditësit nuk kanë paraqitur asnjë provë që të vërtetojnë kushtet veçanërisht të rënda të jetesës, si dhe faktit se të gjithë paditësit (*përveç Tonin Preçi*) janë në marrëdhënie pune.

K.Pr.Civile, në nenin 317 të tij parashikon se: "*Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur:*

- a) detyrimi për ushqim;*
- b) për shpërblimin nga puna;*
- c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore.*

*Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur, ose do të vështirësohet së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci."*

Gjykata çmon se në rastin konkret kemi të bëjmë me dëmshpërblime që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe referuar nenit 317/1/b, ligjvënësi e ka parashikuar shprehimisht mundësinë e dhënies së vendimit në ekzekutim të përkohshëm në këtë rast.

Gjykata, konstaton se nga ana e palës paditëse nuk është paraqitur asnjë provë shkresore për të vërtetuar kushtet e vështira të jetesës. Po ashtu, gjatë procesit gjyqësor nga pala paditëse është pranuar se të gjithë paditësat (*përveç Tonin Preçi*) janë aktualisht në marrëdhënie pune, por nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me këtë fakt. Ndërsa, për paditësin Tonin Preçi janë depozituar në cilësinë e provës shkresore: Raport kredimarrësi e printuar në datë 09.06.2021 dhe certifikata familjare, nga ku rezulton se ai është i martuar dhe me dy fëmijë të mitur.

Sa më sipër, në kushtet kur paditësat Klajdi Hoxhallari, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Denisa Sollaku dhe Ana Livadhi janë aktualisht në marrëdhënie pune, si dhe nga pala paditëse nuk është paraqitur provë shkresore për kushtet e vështira të jetesës së tyre, Gjykata çmon se kërkesa për dhënie e vendimit në ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të K.Pr.Civile, është e pabazuar në ligj dhe duhet të rrëzohet. Ndërsa për paditësin Tonin Preçi, Gjykata çmon se ky kërkim duhet të pranohet, në kushtet kur nga ana e tij në gjykim u provuan kushtet e vështira ekonomike, pasi ai rezulton aktualisht i papunë, i martuar me dy fëmijë të

mitur dhe kredimarrës pranë Banka e Shqipërisë në shumën 300.000 lekë.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, në kushtet kur padia është pranuar pjesërisht, gjykata çmon se edhe shpenzimet gjyqësore duhet t'i ngarohen të paditurit pjesërisht në përpjestim me masën e pranimit të padisë, në bazë të nenit 106 të K.Pr.Civile.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenin 126; 305 e vijues të K. Pr.Civile;

### **V E N D O S I**

- Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë së ngritur nga paditësat Klajdi Hoxhallari, Denisa Sollaku, Holger Deli, Anisa Bala, Valbona Selamaj, Tonin Preçi dhe Ana Livadhi.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin **Klajdi Hoxhallari** me pagën e **2 (dy)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës dhe ; me pagën e **1(një)** muaji për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin **Holger Deli** me pagën e **2 (dy)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës dhe me pagën e **1 (një)** muaji për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen **Anisa Bala** me pagën e **2 (dy)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës dhe me pagën e  $\frac{1}{2}$  ( gjysmë) muaji për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen **Valbona Selamaj** me pagën e **3 (tre)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës ; me pagën e **2 (dy)** muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen **Denisa Sollaku** me pagën e **2 (dy)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës si dhe; me pagën e **1(një)** muaji për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin **Tonin Preçi** me pagën e **3 (tre)** muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës dhe me pagën e (2) dy muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe me pagën e **2 ( dy)** muajve si shpërblim për vjetërsi në punë.
- Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen **Ana Livadhi** me pagën e **2 (dy)**

muajve për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës sipas nenit 148 pika 6 e Kodit të Punës dhe me pagën e **1 (një)** muaji për mosrespektimin e afatit të njoftimit.

- Dhënien e vendimit në ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të K.Pr.Civile për paditësin **Tonin Preçi**.
- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.
- Shpenzimet gjyqësore procedurale i ngarkohen palës së paditur.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe me marrjen formë të prerë është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Kundër vendimit për dhënien me ekzekutim të përkohshëm mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve afat që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve afat që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit.
- U shpall në Tiranë më **14.04.2022**.



**SEKRETARE**

**NADIRE BALLA**



**GJYQTARE**

**TEUTA HOXHA**



***Shpenzimet gjyqësore***

*Takse padie*

*Shpenzime avokatore (Perfaqesuesi i pales paditese 7 X 48.000 leke)*

*Shpenzime avokatore (Perfaqesuesi i pales se paditur)*

**3000 Lekë**

**336.000 Lekë**

**90.000 Lekë**